



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77/16 Gusht 2010) si dhe nenit 92, paragrafi 2, dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për:
 - 1.1 regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare, përfshirë degën e institucioneve mikrofinanciare të huaja;
 - 1.2 transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga institucionet mikrofinanciare;
 - 1.3 detyrimet për njoftime në BQK nga institucionet mikrofinanciare gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë personat juridik që aplikojnë për regjistrim si institucion mikrofinanciar apo degë e institucioneve mikrofinanciare të huaja në Republikën e Kosovës , si dhe për të gjitha institucionet mikrofinanciare dhe degët e institucioneve mikrofinanciare të huaja që janë të regjistruara nga BQK-ja, për të operuar në Republikën e Kosovës.
3. Për qëllimet të kësaj rregullore, përveç nëse përcaktohet ndryshe në mënyrë specifike, dispozitat e kësaj rregullore për Institucionet Mikrofinanciare (IMF) aplikohen edhe për degët e Institucioneve mikrofinanciare të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe/ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimin e kësaj Rregullore:
 - 1.1 **Institucion mikrofinanciar (IMF)** – person juridik i regjistruar nga BQK sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, veprimtaria primare e të cilit është dhënia e kredive dhe ofrimi i

shërbimeve tjera financiare të përcaktuara me këtë rregullore, për subjektet juridike mikro dhe të vogla, ekonominë familjare me të hyra të ulëta dhe për personat fizik me të hyra të ulëta.

1.2 Degë e IMF të huaj - nënkupton degën ligjërisht të varur të IMF-së së huaj, e cila ka selinë kryesore në ndonjë vend jashtë Republikës së Kosovës, është e autorizuar nga autoriteti kompetent i mbikëqyrës financiare për të ushtruar veprimtari mikrofinanciare në vendin ku e ka selinë qendrore si dhe është e regjistruar nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari Mikrofinanciare në Republikën e Kosovës përmes degës.

1.3 Zyrë e IMF-së – vend i veprimtarisë afariste i cili formon një njësi/zyrë ligjërisht të varur të IMF-së, e pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës IMF mund të lejohet që të angazhohet në veprimtari financiare.

1.4 Aksionar kryesor – personi që posedon, vetëm ose në bashkëveprim me persona tjerë, së paku dhjetë përqind (10%) të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote në një IMF.

1.5 Pronar përfitues – person që posedon aksione (ka pronësi) në IMF në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë.

1.6 Drejtor - nënkupton çdo person i emëruar nga aksionarët/themeluesit ose pronaret për të shërbyer si anëtar i Bordit të Drejtorëve të IMF-ve.

1.7 Drejtor i pavarur – nënkuptohet drejtori që është i pavarur nga menaxhmenti i lartë apo personat e ndërlidhur me menaxhmentin e lartë.

1.8 Person i ndërlidhur – çdo person që ka së paku njërin nga marrëdhëniet e mëposhtme me IMF-në:

1.8.1 çdo menaxher i lartë i IMF-së;

1.8.2 çdo person që është i lidhur me menaxherin e lartë të IMF-së me anë të martesës ose afërsisë së gjakut deri në shkallë të dytë.

1.9 Menaxher i lartë – kryeshefi ekzekutiv, zëvendëskryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor për operacione, zyrtari kryesor për rrezik të IMF-së si dhe çdo person i cili i:

1.9.1 raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë apo ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të IMF-së, dhe/ose

1.9.2 është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja.

1.10 Kapital apo kapital aksionar - vlera neto apo fondet e institucionit që paraqesin dallimin mes pasurisë dhe detyrimeve në përputhje me bilancin e gjendjes, i cili pasqyron standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

1.11 Person - nënkupton çdo person fizik apo juridik.

Neni 3

Regjistrimi dhe veprimtaria financiare

1. BQK-ja është institucioni i vetëm përgjegjës në Republikën e Kosovës për regjistrimin e IMF-ve.
2. Subjektet juridike që kërkojnë të regjistrohen për të zhvilluar veprimtari financiare të IMF-ve, duhet të jenë të organizuara dhe të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Në rast se subjekti aplikues juridik themelohet si shoqëri tregtare, atëherë IMF aplikuese duhet të jetë e organizuar si shoqëri aksionare ose degë e huaj.

3. IMF aplikuese për të hapur degë në Republikën e Kosovës duhet të jetë institucion mikrofinanciare i autorizuar dhe i mbikëqyrur nga autoriteti kompetent i mbikëqyrës financiare për të ushtruar veprimtari mikrofinanciare në vendin ku e ka selinë qendrore.
4. IMF-të ushtrojnë veprimtarinë e dhënies së kredive, si veprimtari kryesore dhe shërbime të tjera financiare siç përcaktohet me paragrafin 5 të këtij neni.
5. IMF-të e regjistruara nga BQK-ja, mund të angazhohen edhe në veprimtaritë vijuese, pa qenë subjekt i regjistrimit:
 - 5.1 shërbimi i pagesave lidhur me kreditë e dhëna klientëve;
 - 5.2 përfitimi i fondeve me anë të granteve, apo/dhe huazimeve nga institucionet financiare që ofrojnë huadhënie financiare, me qëllim të huadhënies apo për përdorimin e tyre;
 - 5.3 huazimi nga dhe vendosjen e fondeve në tregje dhe institucione të licencuara nga BQK-ja me qëllim të menaxhimit të likuiditetit të tyre; dhe
 - 5.4 ofrimi i shërbimeve teknike, profesionale dhe trajnimin e klientëve të tyre lidhur me shërbimet financiare.
6. IMF pasi të regjistrohet nga BQK-ja, mund të fillojë me kryerjen e veprimtarive financiare për të cilat ka marrë miratim nga BQK.

Neni 4

Kërkesat për kapital

1. Shuma minimale e kapitalit të kërkuar për regjistrim si IMF është 200,000.00 (dyqind mijë) Euro. Shuma minimale e kapitalit nga ky paragraf duhet të mirëmbahet në çdo kohë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së IMF-së. Degët e IMF-ve të huaja, janë të obliguara që kapitalin e kërkuar nga ky paragraf ta mbajnë në para të gatshme të bllokuar si depozitë me afat në një llogari bankare në bankat e licencuara nga BQK.
2. Përveç kapitalit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, IMF duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se dhjetë për qind (10%) e kapitalit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Kërkesa për fond shtesë sipas këtij paragrafi, aplikohet vetëm për aplikacionet fillestare për regjistrim si IMF.
3. BQK, bazuar në vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, të dhënave mbi rrezikun e humbjeve dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, mund të kërkojë në çdo kohë nivele shtesë kapitali deri në 20% (njëzet për qind) mbi nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar.
4. Gjithsej kapitali në raport me gjithsej mjetet e IMF-së asnjëherë nuk duhet të jetë më i vogël se 10% (dhjetë për qind).
5. Pagesa e kapitalit minimal dhe çdo shtesë e mëvonshme lidhur me të, duhet të bëhet në para të gatshme dhe shoqërohet me paraqitjen në BQK të informatave lidhur me burimin e këtij kapitalit dhe dokumentin bankar që vërteton pagesën e kapitalit, ashtu siç është e përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafët 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
6. BQK-ja ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e fondeve, që do të shërbejnë si kapital fillestar ose si shtesë e mëvonshme e kapitalit.

7. Burimet e fondeve të kapitalit duhet të jenë të ligjshme dhe nuk duhet të rrjedhin nga huat nga publiku, kreditë dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme ose e paqartë.

Neni 5

Kërkesa e përgjithshme për regjistrim

1. Të interesuarit për regjistrim si IMF duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, këtë rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të BQK-së. Aplikuesi mund të kërkojë format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre nga BQK-ja vetëm pas takimit informues të mbajtur me përfaqësuesit e BQK-së.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga aksionarët/themeluesit apo përfaqësuesi ligjor i tyre dhe dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të aksionarëve/themeluesëve ose përfaqësuesit ligjor të IMF-së së propozuar. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, këtë Rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të BQK-së.
3. Kërkesat për regjistrim si IMF duhet të jenë në formë të shkruar, e shoqëruar nga formularët e plotësuar sipas formatit të BQK-së dhe do të përfshijë dokumentacionet/informacionet vijuese:
 - 3.1. dokumentet e aplikuesit (akti i themelimit dhe/ose statuti);
 - 3.2. certifikata e regjistrimit si subjekt juridik;
 - 3.3. lista e aksionarëve/themeluesëve (dhe anëtarëve nëse është e aplikueshme) si dhe pronarëve përfitues të aplikuesit për regjistrim si IMF, duke cekur emrin, nacionalitetin, adresën, historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit si dhe posedimin përkatës të aksioneve së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm (për aksionarët kryesor në rast se IMF aplikuese është shoqëri aksionare):
 - 3.3.1. Për aksionarët që janë të organizuar si shoqëri tregtare (persona juridik dhe/ose personat fizik) sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare:
 - 3.3.1.1. statuti dhe dokumentacioni i regjistrimit të biznesit (për personat juridikë të huaj aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);
 - 3.3.1.2. vendimi i organit vendimmarrës të personit juridik dhe/ose personat fizik të organizuar si shoqëri tregtare për pjesëmarrjen në kapitalin e IMF-së;
 - 3.3.2. Për personat fizik, që nuk janë të organizuar si shoqëri tregtare:
 - 3.3.2.1. dokumenti i identifikimit i lëshuar nga shteti, shtetas i të cilit është aksionari i propozuar, dhe adresa e saktë e vendbanimit; dhe
 - 3.3.2.2. lista e bizneseve në të cilat ka pjesëmarrje, certifikatat e regjistrimit të biznesit për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi;
 - 3.3.3. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin aksionari:
 - 3.3.3.1. se personi nuk është në hetime për vepra penale;
 - 3.3.3.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.3.3.3. se personi nuk është i dënuar penalisht;
 - 3.3.3.4. nga Oda e Përmbanuesëve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera (apo dokument ekuivalent të tij varësisht nga legjislacioni i vendit nga vjen aksionari i propozuar);

- 3.3.3.5. se personi nuk ka dosje personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organ tjetër të shoqërisë tregtare, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese;
 - 3.3.3.6. pëlqimi/autorizimi që i lejon BQK-së verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
 - 3.3.3.7. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuara jo më herët se tre (3) muaj nga data e aplikimit në BQK.
- 3.4. shumën e kapitalit të zotuar të aplikuesit për regjistrim si IMF, duke përfshirë dëshminë e pagesës si dhe dokumentacionin për burimin e tij:
- 3.4.1. deklaratë noteriale të aksionarëve për burimin e kapitalit të paguar dhe se burimi i këtij kapitali nuk është hua nga publiku, kredi dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.
 - 3.4.2. për aksionarët të organizuar si shoqëri tregtare, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.2.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të aplikuesit;
 - 3.4.2.2. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.
 - 3.4.3. për aksionarët persona fizik, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.3.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje dhe shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - 3.4.3.2. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;
 - 3.4.3.3. kontributet për kapitalin e aplikuesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.
- 3.5. emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e drejtorit dhe/apo menaxherit të lartë të IMF-së, të cilat duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
- 3.5.1. vendimin e organit vendimmarrës për emërim;
 - 3.5.2. dokumentin e identifikimit;
 - 3.5.3. dëshminë për përgatitjen shkollore universitare;
 - 3.5.4. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin për drejtorët, menaxherët e lartë dhe (nëse është e aplikueshme) përfaqësuesin ligjor:
 - 3.5.4.1. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - 3.5.4.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.5.4.3. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
 - 3.5.4.4. nga Oda e Përmbauesëve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime të pashlyera;
 - 3.5.4.5. se personi nuk ka dosje personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të

ndonjë korporate ose organ tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese;

3.5.4.6. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;

3.5.4.7. pëlqimin/autorizimin që i lejojnë BQK-së verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;

3.5.4.8. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuar jo më herët se tre (3) muaj nga data e aplikimit në BQK.

3.6. Plani i biznesit me përmbajtje si më poshtë:

3.6.1. struktura e organizimit të aplikuesit për regjistrim si IMF dhe niveli i përgjegjësisë/ve;

3.6.2. veprimtaritë financiare që parashikon IMF të kryejë, vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;

3.6.3. identifikimi i rreziqeve, ndaj të cilave aplikuesit për regjistrim si IMF është e ekspozuar, duke përfshirë dhe zyrat;

3.6.4. parashikimi i gjendjes financiare të aplikuesit për regjistrim si IMF për tre (3) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së saj pas regjistrimit (pasqyrat financiare të parashikuara);

3.6.5. burimet e financimit dhe struktura e mjeteve për tre (3) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë pas regjistrimit;

3.6.6. parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit;

3.6.7. një informacion lidhur me zyrat ku aplikuesit për regjistrim si IMF parashikon të kryejë veprimtarinë/të; dhe

3.6.8. një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës për tre (3) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë.

3.6.9. një përshkrim të pajisjeve teknike dhe burimeve të nevojshme për të kryer veprimtarinë, duke përfshirë këtu sisteme të përshtatshme kompjuterike, informatike, kontabël dhe të regjistrimit;

3.7. aktet e brendshme rregullative (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme), të miratuara nga organet vendimmarrëse për:

3.7.1. veprimtarinë operacionale të aplikuesit për regjistrim si IMF;

3.7.2. sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive të kontrollit të brendshëm, për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

3.7.3. mbrojtjen e konsumatorit;

3.7.4. menaxhimin e rreziqeve;

3.7.5. parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë një program masash në përputhje me legjislacionin në fuqi;

3.7.6. një përshkrim të planit për vazhdimësinë e punës që përfshin një identifikim të qartë të operacioneve kritike, planin efektiv të emergjencave dhe procedurë për testim dhe rishikim të vazhdueshëm të këtyre planeve;

3.7.7. organizimin, funksionimin dhe menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë mënyrën e mbrojtjes/sigurisë së informacionit dhe të dhënave të klientëve.

3.8. në çdo rast kur aplikuesi është një institucion financiar i huaj, që aplikon të themelojë një IMF në Kosovë, nevojitet një deklaratë nga mbikëqyrësi në vendin amë, nëse është e aplikueshme, se nuk ka asnjë kundërshtim për themelimin e propozuar të operacioneve në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar për aplikuesit për regjistrim si IMF;

3.9. listën e tarifave të planifikuara për produkte dhe shërbimet e ofruara;

- 3.10. dëshminë e pagesës së tarifës për regjistrim si IMF;
- 3.11. informata shtesë nëse BQK e konsideron të arsyeshme.
4. Dokumentacioni i kërkuar sipas paragrafëve të këtij neni, aplikohet përshtatshëm në rastet kur IMF aplikuese nuk është e organizuar si shoqëri tregtare.
5. Dokumentacioni i kërkuar sipas këtij neni duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Kosovës, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të shteteve përkatëse.

Neni 6

Procedura dhe kushtet e regjistrimit

1. BQK-ja bën shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, këtë rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të BQK-së.
2. Në pajtim me nenin 92 të Ligjit për bankat, BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon regjistrimin si institucion mikrofinanciar brenda 90 ditësh nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Bordi Ekzekutiv do të vlerësoj nevojën e trajtimit të afatit në pajtim me nenin 92 paragrafi 4 të Ligjit për bankat.
3. Në kuadër të periudhës prej 90 ditësh për vendosje lidhur me regjistrimin si institucion mikrofinanciar siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, përfshihet edhe periudha e shfrytëzuar për çështje procedurale për vendimmarrje nga ana e Bordit Ekzekutiv.
4. Për qëllim të paragrafit 2 të këtij neni, data e pranimit të kërkesës/aplikacionit për regjistrim si institucion financiar, konsiderohet si datë e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar. Njoftimi sipas këtij paragrafi i konfirmohet me shkrim aplikuesit.
5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme.
6. Nëse BQK konsideron se informacioni i dhënë në njoftim është jo i plotë ose i pasaktë, BQK mund të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të verifikuar informacionin.
7. Kushtet për miratimin apo refuzimin e regjistrimit:
 - 7.1. BQK-ja merr vendim për miratimin e regjistrimit nëse konstaton se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:
 - 7.1.1. aksionarët/themeluesit të kenë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të fondeve të kapitalit, të kenë mundësi financiare për investimin e fondeve të planifikuara, si dhe mundësi financiare për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së institucionit;
 - 7.1.2. nëse është e aplikueshme, në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një IMF e huaj që propozon themelimin e një subjekti të varur ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të

- aktiviteteve të propozuara në Kosovë, dhe se ushtron mbikëqyrje globale të konsoliduar të veprimtarisë ndaj IMF së huaj;
- 7.1.3. shuma e kapitalit dhe fondit shtesë të kërkuar sipas nenit 4 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj rregullore është paguar;
- 7.1.4. kualifikimet, përvoja dhe reputacioni i anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të jetë e përshtatshme për realizimin e planit të biznesit siç është përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregullore. Në rast se IMF aplikuese është degë e IMF-së së huaj kjo dispozitë aplikohet vetëm për menaxherët e lartë;
- 7.1.5. plani i biznesit i paraqitur duhet të jetë real dhe konkurrues në treg dhe gjendja e pritshme financiare e IMF-së së propozuar të jetë e kënaqshme;
- 7.2. BQK-ja refuzon kërkesën për miratim të regjistrimit, në rastet e mëposhtme:
- 7.2.1. nuk plotësohen kushtet e përcaktuara më lartë, në nënparagrafin 7.1 të paragrafit 7 të këtij neni;
- 7.2.2. vë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të IMF-së së propozuar ose të sistemit të IMF-ve në përgjithësi;
- 7.2.3. njëri nga aksionarët/themeluesit ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese përfshirë administrimin zyrtarë ose falimentimin;
- 7.2.4. nëse prejardhja e kapitalit aksionar të investuar, nuk është e qartë për BQK-në;
- 7.2.5. zvogëlonte në mënyrë substanciale konkurrencën.
- 7.2.6. gjatë aplikacionit janë deklaruar informata të rrejshme/falsifikuara.
- 7.3. BQK, për të kryer vlerësimet e përcaktuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe mund të kërkojë informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave; organet tatimore; Autoriteti i Konkurrencës ose ndonjë tjetër institucion relevant vendor apo ndërkombëtar.
- 7.4. Në vendimin për refuzimin e regjistrimit shënohen arsyet pse është refuzuar regjistrimi.

Neni 7

Karakteristikat e regjistrimit

1. Regjistrimi miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është i transferueshëm.
2. Pas regjistrimit, IMF fillon veprimtarinë brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e pranimit të njoftimit/vendimit për regjistrimin.
3. Nëse IMF nuk fillon veprimtarinë sipas afateve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, regjistrimi i miratuar nga BQK revokohet. Institucioni mund të riaplikojë për regjistrim.
4. Certifikata e regjistrimit të IMF-ve, lëshohet në pajtim me Rregulloren e BQK-së për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare.
5. IMF, para se të filloj me veprimtarinë financiare, duhet ta njoftojë BQK-në për përgatitjet e bëra dhe gatishmërinë për të filluar me ushtrimin e veprimtarisë, për krijimin e hapësirës dhe infrastrukturës së përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë, përfshirë edhe instalimin e sistemit operativ të teknologjisë informative.

Neni 8

Tarifat

1. IMF që aplikon për regjistrim duhet të paguajë tarifën për regjistrim, sipas shumës së përcaktuar nga BQK-ja. Kjo tarifë nuk rimbursohet në rast të refuzimit të kërkesës për regjistrim.
2. Pas regjistrimit IMF-ja duhet të paguajë tarifën e tjera sipas mënyrës dhe shumës së përcaktuar nga BQK-ja.

Neni 9

Revokimi ose pezullimi i regjistrimit

1. Në pajtim me nenin 105 të Ligjit nr. 03/L0093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, regjistrimi i IMF mund të revokohet me vendim të BQK-së, për një apo më shumë nga arsyet në vijim:
 - 1.1. nëse IMF-ja nuk ka filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj rregullore;
 - 1.2. nëse IMF-ja ka ndërprerë ushtrimin e veprimtarive për të cilat është regjistruar në BQK, për më shumë se gjashtë (6) muaj pa ndërprerje;
 - 1.3. ekzistojnë të dhëna të besueshme se aksionarët, drejtorët dhe/ose menaxherët e lartë janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
 - 1.4. nëse BQK-ja ka miratuar planin që IMF-ja të përfundojë veprimtarinë në Kosovë dhe i është përmbajtur atij plani;
 - 1.5. nëse IMF-ja ka shkelur ndonjë dispozitë ligjore, ndonjë urdhëresë ose rregullore të BQK-së apo ndonjë kusht ose kufizim, që ndërlihet me autorizimin e lëshuar nga BQK-ja edhe pas paralajmërimit të BQK-së;
 - 1.6. nëse IMF-ja është angazhuar në praktika të pasigurta ose të pashëndosha sipas gjykimit të BQK-së;
 - 1.7. nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ajo është regjistruar;
 - 1.8. nëse regjistrimi është marrë në bazë të dokumentacionit/informacionit të rrejshëm ose të falsifikuar.
2. Përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, regjistrimi i IMF do të revokohet me vendim të BQK-së nëse vlerësohet se IMF-ja është josolvente ose arsyeshmërisht pritët të bëhet josolvente. Për qëllimet e këtij paragrafi, “josolvent” do të thotë se situata kur IMF-ja nuk është duke i paguar detyrimet e saj ose vlera e detyrimeve të IMF-së tejkalon vlerën e mjeteve të saj. Vlera e mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të IMF-së përcaktohet në përputhje me standardet e vlerësimit dhe procedurat e përcaktuara nga BQK.
3. BQK-ja kur e vlerëson të arsyeshme, mund të vendos për pezullimin e regjistrimit të IMF-së. Në raste të tilla periodha dhe kushtet tjera lidhur me pezullimin, përcaktohen me vendim të BQK-së.

Neni 10

Transaksionet që kërkojnë miratim paraprak

1. Transaksionet e IMF-ve që kërkojnë miratim paraprak nga BQK, janë si në vijim:
 - 1.1. ndryshimi i emrit;
 - 1.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin;
 - 1.3. rritja e kapitalit aksionar;
 - 1.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar;
 - 1.5. të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin të ndryshimi i listës së aksionarëve kryesor, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në IMF;
 - 1.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë (në rastin e degëve të IMF-ve të huaja, kjo dipozitë aplikohet vetëm për menaxherët e lartë);
 - 1.7. hapja e subjekteve të varura apo degëve jashtë vendit;
 - 1.8. hapja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit;
 - 1.8.1.për qëllime të kësaj rregullore, zhvendosja e zyrave të IMF-ve brenda vendit nënkupton ndryshimin e lokacionit të zyrës përkatëse brenda territori të të njëjtës komunë.
 - 1.9. mbyllja e zyrave brenda vendit;
 - 1.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshëm) i veprimtarisë (portofolios) të IMF , te subjekte tjera kredidhënës;
 - 1.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet;
 - 1.12. shpërndarja e dividendës.
2. Dispozitat e paragrafit 1 nënparagrafët 1.3, 1.4, dhe 1.5 të këtij neni nuk aplikohet për IMF-të që nuk janë të regjistruara si shoqëri tregtare.
3. Dispozita e paragrafit 1 nënparagrafi 1.5 të këtij neni nuk aplikohet për degët e IMF-ve të huaja.
4. BQK miraton ose refuzon transaksionet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e kompletimit të kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni.
5. Për qëllim të paragrafit 4 të këtij neni, data e pranimit të kërkesës konsiderohet si datë e pranimit të kërkesës së kompletuar.
6. Për miratimin e transaksioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, IMF paraqet kërkesë me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 6.1. ndryshimi i emrit:
 - 6.1.1. vendimi i organit vendimmarrës; si dhe
 - 6.1.2. arsyetimi me shkrim për ndryshimin e emrit.
 - 6.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:
 - 6.2.1. vendimi i organit vendimmarrës;
 - 6.2.2. dokumenti i themelimit dhe/ose statuti i ndryshuar;
 - 6.2.3. arsyetimi me shkrim për ndryshimin e dokumentit të themelimit dhe/ose statutit.
 - 6.3. rritja e kapitalit aksionar:
 - 6.3.1. nëse rritja e kapitalit aksionar të IMF-së bëhet nga burime të brendshme të tij;

- 6.3.1.1. deklarata në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit;
 - 6.3.1.2. raporti i auditorit të jashtëm të IMF-së për vitin paraprak;
 - 6.3.1.3. pasqyrat financiare të periudhës së fundit të raportuara në BQK, të cilat vërtetojnë mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së kapitalit të IMF-së.
- 6.3.2. nëse rritja e kapitalit aksionar të IMF-së bëhet nga burimet e jashtme të tij, aplikohen kërkesat e nenit 5 paragrafi 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
- 6.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar:
- 6.4.1. vendimi i organit vendimmarrës;
 - 6.4.2. një përshkrim i ndikimit të këtij ndryshimi në kërkesat për kapital sipas kësaj rregullore;
 - 6.4.3. arsyetimi me shkrim për zvogëlimin e kapitalit aksionar.
- 6.5. ndryshimi i pronësisë së aksionarëve, që posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në kompani:
- 6.5.1. raporti i kompanisë aksionare, në rastin e aksionarëve të organizuar si shoqëri tregtare apo CV-të e aksionarëve individual sipas formës së BQK;
 - 6.5.2. emri, nacionaliteti, vendbanimi dhe historiku afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit të paraqitësit të kërkesës, dhe çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës që, si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të IMF-së si dhe informatat/dokumentacioni i kërkuar në nenin 5, paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 të kësaj rregullore;
 - 6.5.3. lista e shoqërive tregtare në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet me lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyre dhe adresat e regjistruara të këtyre shoqërive tregtare;
 - 6.5.4. për çdo person juridik, pasqyrat e audituara financiare (të audituara nëse është e aplikueshme) për 3 (tre) vitet e fundit;
 - 6.5.5. burimi dhe shuma e fondeve që shfrytëzohen për përvetësimin e aksioneve ashtu siç përcaktohet në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 të kësaj rregullore; dhe
 - 6.5.6. në çdo rast kur përvetësimi i aksioneve do të ndikonte që IMF të bëhet një subjekt i varur i një institucioni financiar të huaj, një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë se nuk ka kundërshtime për fillimin e veprimtarisë në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje globale të konsoliduar ndaj IMF-së të themeluar në Kosovë, nëse është e aplikueshme;
 - 6.5.7. marrëveshja e noterizuar, të nënshkruar për ndryshimin e pronësisë së aksioneve.
- 6.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë:
- 6.6.1. dokumentacioni i kërkuar në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafi 3.5 të kësaj rregullore.
- 6.7. hapja e subjekteve të varura apo degëve jashtë vendit:
- 6.7.1. vendimi i organit vendimmarrës;
 - 6.7.2. vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga dega e propozuar;
 - 6.7.3. biznes-planin për degën për tri (3) vitet e para të aktivitetit si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;
 - 6.7.4. shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;
 - 6.7.5. informata të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga BQK-ja.

6.8. hapja dhe zhvendosja e zyreve:

- 6.8.1. vendimi i organit vendimmarrës;
- 6.8.2. përshkrimi për arsyetimin e hapjes apo zhvendosjes së zyrës;
- 6.8.3. njoftimi me shkrim për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë. Në këtë njoftim duhet specifikuar hapat e ndërmarra lidhur me plotësimin e këtyre kushteve si dhe fotografitë që dëshmojnë një gjë të tillë.

6.9. mbyllja e zyreve:

- 6.9.1. identifikimi i zyrës që do të mbyllet dhe data e propozuar të mbylljes;
- 6.9.2. vendimi i organit vendimmarrës;
- 6.9.3. raporti me arsyet e marrjes së vendimit për mbylljen e zyrës;

6.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshëm) i veprimtarisë (portofolios) të IMF, një entiteti tjetër;

- 6.10.1. vendimi i organit vendimmarrës për këto transaksione;
- 6.10.2. marrëveshja e nënshkruar apo draftmarrëveshja në mes IMF dhe entitetit tjetër.

6.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet:

- 6.11.1. vendimi i organit vendimmarrës të IMF-së dhe institucionit financiar tjetër të përfshirë në veprim për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
- 6.11.2. marrëveshja apo draftmarrëveshja dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të institucioneve të përfshira në procesin e bashkimit. Marrëveshja apo draftmarrëveshja dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 6.11.3. draft statuti i IMF-së pas realizimit, të procesit të bashkimit;
- 6.11.4. planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për IMF-në e bashkuar;
- 6.11.5. në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të IMF-së së bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët siç është e përcaktuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe këtë rregullore;
- 6.11.6. struktura e re e aksionarëve të IMF-së.

6.12. shpërndarja e dividendës:

- 6.12.1. vendimi i kuvendit aksionar dhe bordit të drejtorëve për shpërndarjen e dividendës;
- 6.12.2. parashikimet lidhur me bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, kapitalin bazë, në baza mujore për 12 muajt e ardhshëm, duke reflektuar pagesën potenciale të dividendës;
- 6.12.3. pasqyrat financiare të audituara për vitin paraprak.

7. BQK-ja mund të kërkojë dokumente shtesë përveç atyre të specifikuara në paragrafin 6 të këtij neni.

8. Kërkesa për miratimin e transaksioneve të lartcekura si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në kërkesë duhet të paraqitet nga IMF dhe duhet të jetë në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Kosovës, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të shteteve përkatëse.

9. BQK miraton kërkesat e parashtruara nga IMF-të për transaksionet sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëse plotësohet kriteret e mëposhtme:
- 9.1. ndryshimi i emrit:
- 9.1.1. emri i ri i propozuar i IMF-së duhet të jete në pajtim me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
- 9.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:
- 9.2.1. ndryshimet janë në pajtim me legjislacionin në fuqi, varësisht se për çfarë ndryshimi bëhet fjalë.
- 9.3. rritja e kapitalit aksionar:
- 9.3.1. fondet e kapitalit rrjedhin nga burime të ligjshme.
- 9.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar:
- 9.4.1. zvogëlimi i kapitalit nuk ka ndikim negativ në zvogëlimin e qëndrueshmërisë financiare të IMF-së si dhe strukturën e pronësisë dhe përshtatshmërinë e aksionareve të saj.
- 9.5. transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin te ndryshimi i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në shoqëri;
- 9.5.1. përvetësimi i propozuar vlerësohet sipas kriterëve të njëjta që zbatohen për miratimin të një kërkesë për regjistrimit të IMF-së sa i përket aksionarëve duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimit të propozuar në qëndrueshmërinë financiare të IMF-së, strukturën e pronësisë së IMF-së dhe ndikimin që mund të ketë ky përvetësim në mbikëqyrjen e IMF-së nga BQK.
- 9.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë:
- 9.6.1. drejtorët dhe menaxherët e lartë i plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregullore;
- 9.7. hapja e subjekteve të varura apo degëve jashtë vendit:
- 9.7.1. hapja e subjekteve të varura apo degëve jashtë vendit miratohet nëse sipas gjykimit të BQK-së, një investim i tillë, nuk ndikon negativisht në gjendjen financiare të IMF-së dhe nëse mbikëqyrja e konsoliduar është lehtë e realizueshme.
- 9.8. hapja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit:
- 9.8.1. arsyeshmerine e ndikimit të hapjes apo zhvendosjes në komunitetin në të cilin zyra është apo do të vendoset;
- 9.8.2. IMF duhet t'i ofrojë BQK-së, informata dhe fakte të mjaftueshme se zyra është e gatshme për të zhvilluar veprimtarinë e saj, sa i përket kushteve teknike dhe të sigurisë duke përfshirë sistemin e teknologjisë informative, stafin, sigurimin etj. Për vlerësim të këtij kriteri, aplikohet përshtatshmërisht rregullorja për kërkesat minimale të sigurisë e aplikueshme për banka;
- 9.8.3. BQK-ja ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë në zyrën përkatëse edhe pas miratimit, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare nuk janë përmbushur.

9.9. mbyllja e zyrave brenda vendit:

9.9.1. zvogëlimi i rrjetit të zyrave është vendim biznesi i vetë IMF-së. Pavaresisht kesaj, BQK-ja mund të shtyjë përkohësisht IMF-në deri në 30 ditë kalendarike, në mbylljen e zyrës, nëse sipas gjykimit të BQK-së mbyllja e zyrës do të ketë një ndikim të madh negativ në qasjen në shërbime financiare në komunitetin e shërbyer nga ajo zyre.

9.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshëm) i veprimtarisë (portofolios) të IMF, një entiteti tjetër:

9.10.1. ndikimi i shitjes apo transferimit të veprimtarisë (portofolios) te klientët e IMF-së;

9.10.2. ndikimi i shitjes apo transferimit të veprimtarisë (portofolios) në gjendjen financiare të IMF-së;

9.10.3. shitja apo transferimi i veprimtarisë (portofolis) nuk shkakton efekt kundërkonkurrues;

9.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet:

9.11.1. bashkimi ose përvetësimi nuk rrezikon gjendjen financiare të IMF-së së bashkuar;

9.11.2. IMF ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të IMF-së së bashkuar ose përvetsuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e saj;

9.11.3. bashkimi ose përvetësimi është ekonomikisht i arsyeshëm;

9.11.4. bashkimi dhe/ose përvetësimi nuk shkakton efekt kundërkonkurrues;

9.11.5. është përgjegjësi e IMF-së për të marrë miratime nga autoritetet e tjera që mund të jenë të nevojshme para se transaksioni të ketë përfunduar.

9.12. shpërndarja e dividendës nga IMF-të që janë të organizuara si shoqëri tregtare/aksionare.

9.12.1. BQK-ja do ta miratoj shpërndarjen e dividendes vetëm nëse sipas vlerësimit të saj, pagesa e dividendes nuk do ta vështirësoj gjendjen financiare të IMF-së.

10. BQK-ja gjatë vendosjes për miratimin e këtyre transaksioneve, merr parasysh edhe kritere tjera në funksion të realizimit të qëllimeve të saja të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Transaksionet që kërkojnë njoftim për BQK

1. IMF duhet të njoftojë BQK-në, brenda 30 ditëve nga data kur ndodhin, për transaksionet si në vijim:

1.1. çdo ndryshim në pronësinë e aksionarëve që posedojnë më pak se dhjetë përqind (10%) të kapitalit;

1.2. dorëheqjet e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;

1.3. riemërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;

1.4. ndryshimet në strukturën organizative, nëse ky ndryshim nuk reflektohet në statutin e IMF-së, drejtor apo menaxher të lartë.

2. IMF-të, menjëherë sapo të vëhet në dijeni, duhet të njoftojnë në BQK rreth ngjarjeve të rrezikut operacional, nëse ndodhin ndonjë nga ngjarjet në vijim:

2.1. humbjet financiare si pasojë e vjedhjeve, mashtrimeve financiare apo raste tjera të ngjashme, të cilat paraqesin humbje për IMF-së në shumën monetare mbi 1,000 € (njëmijë euro);

- 2.2. ngjarje, të cilat rezultojnë në dëm serioz ose humbje të të dhënave të rëndësishme të IMF-së, librave të saj, ndërprerje të operacioneve për më tepër se tri orë në dy apo më tepër zyre, apo ndërprerje të operacioneve për më tepër se pesë orë në një zyre dhe e cila ndikon në operacionet normale të IMF-së;
- 2.3. informatat ekskluzive të IMF-se janë vjedhur, shitur apo publikuar pa lejen e IMF-së apo ndonjë informacion i humbur i cili mund ta dëmtoj stabilitetin financiar të IMF-së;
- 2.4. shkelje e shpeshtë e rregullave të aplikueshme nga menaxhmenti i lartë.

Neni 12

Qeverisja e Institucioneve Mikrofinanciare

1. IMF-ja duhet të veprojë në përputhje me parimet e pranuar të qeverisjes së mirë për të siguruar, që biznesi i institucionit realizohet në mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë. Qeverisja në IMF duhet të jetë në pajtueshmëri me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare si dhe me këtë rregullore.
2. Sikurse përcaktohet me nenin 97 paragrafi 1 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, IMF-të duhet të kenë bord të drejtorëve që përbëhet nga jo më pak se tre (3) anëtar, nga të cilët shumica duhet të jenë drejtor të pavarur dhe jo ekzekutiv.
3. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të plotësojnë kriteret “i përshtatshëm dhe i duhur” siç kërkohet nga BQK-ja.
4. Drejtorët dhe menaxherët e lartë të institucionit mikrofinanciar, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:
 - 4.1. të kenë diplomë universitare në ekonomi, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 4.2. të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre (3) vjet në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga BQK;
 - 4.3. të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - 4.4. të mos jenë të larguar nga posti në një institucion financiar nga BQK-ja;
 - 4.5. të mos jenë të dënuar nga një gjykatë penale për vepër penale për të cilën është percaktuar dënim me burgim prej një viti a më shumë, për të cilat nuk është percaktuar opsioni i gjobës;
 - 4.6. të mos jenë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë sipas Kodit Penal;
 - 4.7. personi të cilit, sipas vendimit të gjykatës/autoritetit kompetent i është mohuar ushtrimi i veprimtarive në kuadër të kompetencave të përcaktuara për drejtorët dhe menaxherët e lartë;
 - 4.8. nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit për shkak të sjelljes së pahijshme personale;
 - 4.9. të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;
 - 4.10. të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese përfshirë administrimin zyrtar ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara.
5. Në rrethana të veçanta, pasi që të jetë e kënaqur me kualifikimet, përvojën profesionale dhe sjelljen e personit, BQK-ja mund ta lirojë një drejtor ose menaxher të lartë nga dispozitat e nënparagrafit 4.10 të paragrafit 4 të këtij neni.

6. Sikurse kërkohet me nenin 98 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, bordi i drejtorëve të IMF-ve ndihmohet nga së paku dy komitete:
 - 6.1. komiteti i auditimit i cili përfshin dhe kryesohet nga një anëtar joekzekutiv i bordit të drejtorëve dhe së paku një anëtar i komitetit të auditimit mund të jetë një ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit; dhe
 - 6.2. komiteti për menaxhimin e riskut anëtarët e të cilit duhet të jenë edhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve;
7. BQK mund të kërkojë nga IMF-të të kenë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, përfshirë komitete në nivel të menaxhmentit të lartë.
8. IMF-të mund të themelojnë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare si dhe komitete tjera në kuadër të menaxhmentit të lartë.
9. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me Bordin e Drejtorëve dhe Komitetet në nivel të Bordit të Drejtorëve nuk aplikohen për degët e IMF-ve të huaja.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Asnje person nuk lejohet të bëjë reklama identifikuese për një IMF-të pa u regjistruar së pari në BQK.
2. BQK-ja mund të kryejë inspektim në vend të IMF-së para fillimit të veprimtarisë për të cilën është regjistruar. Qëllimi i këtij ekzaminimi është të vlerësojë nëse zyra në fjalë ka krijuar kushte për të përmbushur detyrimet e përcaktuara me kushtet teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat IMF do të ushtroj veprimtarinë.
3. BQK-ja në çdo kohë mund të inspektojë zyret që kryejnë veprimtari financiare, me qëllim verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligj dhe këtë rregullore.
4. IMF duhet të vendosin certifikatën e tyre të regjistrimit nga BQK-ja në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tyre.

Neni 14

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkimeve administrative, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe Ligjin për Bankat, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare.

Neni 15
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla e Plotësuar XIV mbi Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve Mikro-Financiare Autorizuar sipas Nenit 3, 6, dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21, e miratuar nga Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës më 7 shkurt 2007.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetari i Bordit

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës